

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË “ENTI KOMBËTAR I OPERIMIT RRUGOR” SH.A**

Neni 1

**Forma dhe emërtimi i shoqërisë**

1. Shoqëria është person juridik publik, që ka formën ligjore të shoqërisë aksionare me ofertë private, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar (këtu e në vijim ligji nr. 9901/2008”).
2. Emri i shoqërisë është “Enti Kombëtar i Operimit Rrugor” sh.a (këtu e në vijim “shoqëria”).
3. Aksionar i Vetëm i shoqërisë është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.
4. Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi dhe nga ky statut.

Neni 2

**Selia e shoqërisë, stema dhe vula**

1. Selia e shoqërisë është në adresën, rruga “Princ Vidi” nr. 18/3, Tiranë.
2. Shoqëria mund të hapë dhe të mbyllë zyra dhe degë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.
3. Shoqëria ka stemën dhe vulën e saj, të cilat miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 3

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është pa afat të përcaktuar.

Neni 4

**Qëllimi i shoqërisë**

Qëllimi i Shoqërisë është të ofrojë shërbimin e operimit për mundësimin e aksesit në rrugë të përdoruesve.

Neni 5

**Objekti i Shoqërisë**

1. Objekti i Shoqërisë është kryerja kundrejt pagesës e shërbimeve të mëposhtme:
  - a) operimin e rrugëve me pagesë;
  - b) mirëmbajtjen e infrastrukturës së operimit, e cila përfshin sistemin e portave të automatizuara për lejimin e hyrje-daljeve në rrugë, sistemin elektronik për mbledhjen e tarifave dhe serverat e nevojshëm për mbajtjen e përpunimin e të dhënave dhe të arkëtimit të përkatës;
  - c) prodhimin dhe shpërndarjen e biletave të pajtimit mujor (aboneve) për përdoruesit e rrugëve me pagesë;
  - ç) arkëtimin e tarifës në rrugët me pagesë;
  - d) monitorimin dhe koordinimin e shërbimit të operimit në rrugët me pagesë, operimi i të cilave kryhet nga shoqëritë koncesionare përkatëse;
  - dh) sigurimin e sistemeve dhe aplikacioneve elektronike për menaxhimin dhe përdorimin e

- portave të automatizuara për lejimin e hyrje-daljeve në rrugë, për mbledhjen e tarifave dhe serverave të nevojshëm për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave e të arkëtimeve përkatëse.
2. Shoqëria ofron shërbime të tjera shtesë të lejuara nga legjislacioni në fuqi për subjektet publike dhe private, në përputhje me qëllimin e krijimit dhe fushën e veprimtarisë së saj.
  3. Për përmbushjen e veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
  4. Shoqëria brenda kufijve që parashikon legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet dretpërsëdrejti ose tërthorazi me objektin e saj.
  5. Veprimtaritë e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të pikës 1, të këtij neni, kryhen nga shoqëria., përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në kontratat përkatëse të koncesionit.
  6. Për rrugët me pagesë, të cilat nuk janë në kontrata koncesioni dhe mirëmbahen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, Shoqëria lidh marrëveshje të veçantë me Autoritetin Rrugor Shqiptar për kryerjen e veprimtarive të parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të pikës 1, të këtij neni.

#### Neni 6

### **Kapitali themeltar i Shoqërisë**

1. Kapitali i Shoqërisë është 100% shtetëror.
2. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, dhe është i ndarë në 50 000 (pesëdhjetë mijë) aksione, me vlerë nominale 1 000 (njëmijë) lekë secili.
3. Aksionari i vetëm i 100% të aksioneve të shoqërisë është shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
4. Kapitali themeltar transferohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë tek Shoqëria, menjëherë pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
5. Aksionet janë të formës nominale dhe të patransferueshme.

#### Neni 7

### **Zmadhimi i kapitalit**

1. Zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet me derdhje në para ose me kontribute në natyrë, nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese.
3. Në çdo rast, kontributet shoqërohen me një certifikatë për nënshkrimin e tyre ose një raport vlerësimi, të kryer nga një ekspert i vlerësimit të kontributeve në natyrë.
4. Aksionet e nënshkruara me kontribute në para, duhet të shlyhen të paktën  $\frac{1}{4}$  e vlerës nominale në momentin e nënshkrimit. Pjesa që mbetet, paguhet në përputhje me vendimin përkatës dhe në përputhje të plotë me rregullat e vendosura për këtë qëllim nga autoritetet mbikëqyrëse të aktivitetit të shoqërisë.

#### Neni 8

### **Zvogëlimi i kapitalit**

Asambleja e Përgjithshme vendos për zvogëlimin e kapitalit, sipas këtij statuti.

#### Neni 9

### **Akti i emetimit të aksioneve**

1. Aksionet e Shoqërisë emetohen mbi bazën e Aktit të Emetimit, i cili miratohet nga Administratori në lidhje me pjesën e realizuar.
2. Aksionet e reja nuk mund të emetohen përpara hyrjes në fuqi të zmadhimit dhe miratimit të Aktit të Emetimit.
3. Akti i Emetimit duhet të përmbajë të dhënat e kërkuara nga ligji nr. 9901/2008.

#### Neni 10

#### **Regjistri i aksioneve**

1. Administratori mban Regjistrin e Aksioneve, me qëllim pasqyrimin e çdo të drejte të aksionarëve apo palëve të treta mbi aksionet e Shoqërisë.
2. Regjistri i Aksioneve duhet të përmbajë të dhënat e kërkuara nga ligji nr. 9901/2008.
3. Pronësia mbi aksionet dhe çdo e drejtë e lidhur me to, nuk mund të ushtrohet kundrejt Shoqërisë apo palëve të treta, përpara regjistrimit të kësaj pronësie në Regjistrin e Aksioneve të mbajtur nga shoqëria.
4. Aksionari i vetëm pajiset me ekstraktin e Regjistrit të Aksioneve.
5. Administratori duhet të raportojë brenda afateve të kërkuara, çdo ndryshim të të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Aksioneve të shoqërisë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

#### Neni 11

#### **Organet e shoqërisë**

1. Shoqëria organizohet sipas sistemit të drejtimit me dy nivele.
2. Organet e shoqërisë janë:
  - a) Asambleja e Përgjithshme;
  - b) Këshilli Mbikëqyrës;
  - c) Administratori.

#### Neni 12

#### **Asambleja e Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, janë detyruese për shoqërinë, aksionarët, organet e tjera, si dhe zyrtarët e shoqërisë.
2. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Aksionari i Vetëm i shoqërisë.
3. Asambledhja e përgjithshme merr vendime për çështjet si më poshtë:
  - a) përcaktimin dhe miratimin e politikave të përgjithshme etregtare dhe të investimit të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, si dhe miratimin e skemës së shpërblimeve për këta anëtarë;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
  - ç) emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, audituesit ligjorë dhe të likuiduesve, si dhe miratimin e skemës së shpërblimeve të tyre;
  - d) monitorimin dhe mbikëqyrjen e performancës së Këshillit Mbikëqyrës;
  - dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore të llogarive, si dhe të raportit të ecurisë së veprimtarisë;

- e) ndryshimin e Statutit;
- ë) miratimin e blerjes, pjesëtimit apo anulimit të aksioneve;
- f) miratimin e rritjes ose zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
- g) miratimin e ri-organizimit dhe likuidimit të Shoqërisë;
- gj) miratimin e shpërndarjes së fitimeve vjetore, si dhe i mbulimit të humbjeve;
- h) miratimin mbi pjesëmarrjen e Shoqërisë në kapitalin e shoqërive të tjera;
- i) miratimin mbi lëshimin e titujve të borxhit;
- j) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj administratorit;
- l) miratimin e strukturave ad hoc, ose subjekteve që ushtrojnë kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së shoqërisë për llogari të tij;
- ll) kërkimin e raporteve në kuadër të llogaridhënies nga organet e shoqërisë për çështje specifike ose lidhur me ecurinë e përgjithshme të shoqërisë;
- m) miraton strukturën organizative të Shoqërisë, rregulloren e brendshme dhe Kodin Etik, të shoqërisë;
- n) çështje të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi apo statuti.

4. Asambleja e Përgjithshme jep miratimin paraprak mbi:

- a) partneritete apo marrëveshje në të cilat shoqëria do të jetë palë;
- b) veprime sipas nenit 13, të ligjit nr. nr. 9901/2008, duke përfshirë por pa u kufizuar në ndryshimin apo zgjidhjen e kontratave apo të çdo marrëveshje tjetër ndërmjet Shoqërisë nga njëra anë dhe Administratorit, anëtarit/ëve të Këshillit Mbikëqyrës apo çdo pale të tretë e cila konsiderohet se është e lidhur me Administratorin apo anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, sipas legjislacionit në fuqi;
- c) lidhjen, ndryshimin apo zgjidhjen e një marrëveshjeje huaje apo kredie, ose marrëveshje të tjera, në rastet kur vlera e borxhit e tejkalon shumë prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë;
- ç) heqjen dorë nga një e drejtë me një vlerë nominale që tejkalon 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;
- d) shitjen, qiranë, huapërdorjen apo çdo lloj disponimi të aseteve të luajtshme nëse vlera e një kontrate është mbi 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë ose nëse vlera kumulative e kontratave është mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, brenda një viti financiar.

5. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, brenda 2 ditëve kalendarike nga nxjerrja e tyre, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Administratori kryen regjistrimin e vendimeve.

6. Administratori mund të urdhërojë një punonjës tjetër të shoqërisë për kryerjen e regjistrimit pa vonesë.

### Neni 13

#### **Këshilli Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës është organi që ushtron funksione mbikëqyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë.  
Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë individë të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë, administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës detyrohet të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi ose papajtueshmërie për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tyre.
4. Këshilli Mbikëqyrës do të ketë në përmbajtje të tij gjithnjë jo më pak se 3 (tre) anëtarë.
5. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen për një periudhë 3-vjeçare. Afati i emërimit mund të rinovohet dhe ato mund të shkarkohen në çdo kohë nga Aksionari i vetëm.
6. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë individë të cilët nuk mund të jenë në marrëdhënie

pune me shoqërinë.

7. Zëvendësimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, kur pozicioni bëhet vakant për shkaqe të ndryshme, si rregull bëhet jo më vonë se 3 (tre) muaj.

8. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 2 (dy) Këshilla Mbikëqyrës të shoqërive aksionare, që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 14

### **Kryetari dhe sekretari i Këshillit Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e tij të parë zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një Kryetar. Anëtari që zgjidhet Kryetar e ushtron këtë të drejtë për të gjithë kohën e mandatit të tij në Këshillin Mbikëqyrës dhe mund të rizgjidhet. Kryetari është përgjegjës për thërritjen e mbledhjeve dhe drejtimin e diskutimeve.

2. Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton atij dhe pagën, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në rast mungese të kryetarit, mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës drejtohen nga njëri nga anëtarët e tjerë të këshillit, i cili caktohet me votim nga anëtarët për drejtimin e vetëm të asaj mbledhjeje.

#### Neni 15

### **Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës ushtron funksione kontrolli dhe mbikëqyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë, në përputhje me ligjin nr. 9901/2008 dhe statutin.

2. Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

3. Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;

b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

ç) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

d) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

dh) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit mbikëqyrës për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

e) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit. Raporti i këshillit, përmendur në shkronjën "e", të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

- ë) të gjykojë paraprakisht planin e biznesit të shoqërisë, të paraqitur nga administratori. Ky dokument duhet të miratohet e të nënshkruhet nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, përpara se të dërgohet për miratim pranë Asamblesë së Përgjithshme.
- f) Të miratojë planin e investimeve kapitale dhe buxhetin vjetor të shoqërisë dhe ta dërgojë për miratim pranë Asamblesë së Përgjithshme;
- g) miratimin e rregulloreve të brendshme mbi funksionimin e shoqërisë;
- gj) çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit nr. 9901/2008 është kompetencë e Këshillit Mbikëqyrës.

#### Neni 16

### **Mbledhja dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet jo më pak se një herë në muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e Kryetarit ose Administratorit.
2. Kryetari duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur administratori ose 2 (dy) prej anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.
3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkues mund të thërrasin Këshillin e Mbikëqyrës duke i përcaktuar rendin e ditës.
4. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tri) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë ose në rrugë elektronike.
5. Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës. Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrjen e bërë për këtë qëllim.
6. Këshilli i Mbikëqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje.
7. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes nga sekretari i Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
8. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Kopjet e këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari dhe sekretari.

#### Neni 17

### **Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës përfundon në rastet e mëposhtme:
  - a) Me mbarimin e mandatit të administratorit.
  - b) Me konstatimin e atyre rrethanave, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tyre, siç mund të jenë kur:
    - i. anëtari ndërron jetë apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarin e vdekjes së tij;
    - ii. anëtari humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
    - iii. plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;
    - iv. konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;
    - v. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

#### Neni 18

### **Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës caktohet nga Asambleja e Përgjithshme, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore në fuqi.

### Administratori i shoqërisë

1. Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i shoqërisë mund të riemërohet.
2. Administratori emërohet për një afat prej 3 vitesh dhe mund të shkarkohet në çdo moment nga organi që e ka emëruar.
3. Administratori i Shoqërisë ndalohet të punësohet si administrator, të mbajë një pozicion drejtues apo të jetë i punësuar në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me Shoqërinë.
4. Administratori ka tagra të plota për të vepruar në emër të shoqërisë, sipas përcaktimeve të statutit dhe legjislacionit në fuqi
4. Administratori ka këto kompetenca dhe detyra:
  - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
  - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare me të tretët dhe të ketë rolin e punëmarrësit në marrëdhëniet e punës me punonjësit e shoqërisë;
  - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) menaxhon dhe është përgjegjës për aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet zbatimit të politikave e të planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
  - d) harton planet e biznesit të shoqërisë dhe i paraqet për miratim në Këshillin Mbikëqyrës;
  - dh) harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë, e cila miratohet nga Këshilli i Mbikëqyrës.
  - e) i paraqet Këshillit Mbikëqyrës një raport një herë në tre muaj për ecurinë e shoqërisë.
  - ë) Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, administratori duhet t'i paraqesë Këshillit Mbikëqyrës llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli;
  - f) raporton përpara Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
  - g) nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoluar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat i paraqet për miratim pranë Këshillit Mbikëqyrës, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të cilat më pas paraqiten për miratim pranë Asamblesë së Përgjithshme;
  - gj) lidh kontrata dhe marrëveshje në emër të shoqërisë
  - h) siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë vendas apo të huaj në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë;
  - j) nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshëm të detyrueshëm për menaxhimin administrativ e financiar të shoqërisë;
  - k) organizon e bashkërendon punën ndërmjet sektorëve në përbërje funksionale të shoqërisë;
  - l) krijon një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
  - ll) kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe ligjeve të tjera në fuqi;
  - m) i paraqet propozime dhe sugjerime Këshillit Mbikëqyrës, në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet;
  - n) siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës;
  - nj) drejton veprimtarinë e shoqërisë, zgjedh dhe mbikëqyr personelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Mbikëqyrës;

o) çdo detyrë dhe përgjegjësi tjetër që i ngarkohet siaps legjislacionit në fuqi.

#### Neni 20

### **Shkarkimi i administratorit dhe përfundimi i mandatit**

1. Këshilli Mbikëqyrës mund të propozojë pranë Asamblesë së Përgjithshme shkarkimin e administratorit me shumicë të thjeshtë votash në rast të konstatimit të mospërbushjes së objektivave të kontratës ndërmjet palëve.
2. Mandati i administratorit të shoqërisë përfundon me konstatimin e atyre rrethanave, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tij, ose kur shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në çdo kohë Administratorin.

#### Neni 21

### **Detyrimi i besnikërisë**

Administratori, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe çdo person tjetër që merr pjesë në mbledhjet e këtyrë organeve duhet të ruajë fshehtësinë për çështjet dhe të dhënat që kanë karakter të brendshëm.

#### Neni 22

### **Ekspertët kontabël të autorizuar dhe audituesit ligjor**

1. Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 1 (një) vjeçare dhe kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Auditimi ligjor i shoqërisë kryhet nga audituesit ligjorë, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 1 (një) vjeçare.

#### Neni 23

### **Ushtrimi kontabël**

Ushtrimi kontabël fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

#### Neni 24

### **Inventari – llogaritë vjetore**

1. Mbajtja e kontabilitetit dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar.
2. Në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, shoqëria i harton pasqyrat financiare vjetore në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar.
3. Administratori përgatit, në datën e pasqyrave financiare, raportin e administrimit për gjendjen dhe performancën e shoqërisë gjatë ushtrimit kontabël.

#### Neni 25

Neni 25  
**Likuidimi i shoqërisë**

Likuidimi i shoqërisë të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Neni 26  
**Dispozita të fundit**

1. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të shoqërisë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.
2. Të gjitha mosmarrëveshjet gjatë funksionimit të shoqërisë zgjidhen me mirëkuptim ose i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
3. Ky statut ndryshohet ose zëvendësohet vetëm me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
4. Ky statut hyn në fuqi me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.
5. Statuti hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje të barazvlefshme, në gjuhën shqipe.

**AKSIONAR I VETËM**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**DHE**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

  
Belinda Balluku

REPUBLICA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
TIRANË